



Frosiup Ayollari
Bujaku



Refik Xano
Xif

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 53/4 Prot.

Vlorë më, 06.03.2024

VENDIM
Nr. 9, datë 06.03.2024

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER I
SHKENCAVE NË ADMINISTRIM PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen , riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" si dhe referuar propozimit të Zëvendësrektorit Akademik me shkresë 520/2, datë 05.03.2024. Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 06.03.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Programit të studimit "Master i Shkencave në Administrim Publik" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë si dhe Zëvendësrektorit Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof.Dr. ROLAND ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ZV/REKTORI AKADEMIK

Nr. 522/Prot
12

Vlorë, më 06.03.2024

Lënda: Përcillet për miratim Rregullorja e programit të studimit të riorganizuar mbi 20%,
"Master i Shkencave në Administrim Publik".

PROF.DR.ROLAND ZISI
KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

KËTU

Në vazhdimësi të procedurave për riorganizimin mbi 20% të programit të studimit MP ne Administrim Publik , bazuar në shkresën e MAS me Nr.1368 prot datë 19.02.2024, protokolluar prej nesh me Nr.438 prot datë 21.02.2024 si dhe në zbatim të Udhëzimit të MAS me Nr.1 datë 14.01.2020," Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve , degëve të tyre, njësite kryesore dhe programeve të studimit, si dhe ndarjen apo bashkimin e IAL-ve ", Kreu IV/B, pika 3/c, ju përcjellim për miratim:

- **Rregulloren e programit të studimit të riorganizuar Master i Shkencave në "Administrim Publik"**

Rregullorja është përcjellë me shkresën e Fakultetit të Ekonomisë nr. 46/2, datë 29.02.2024, protokolluar pranë nesh me nr 520, datë 28.02.2024.

Bashkëlidhur kësaj shkrese:

- Shkresa e Fakultetit të Ekonomisë nr. 46/2, datë 29.02.2024.
- Shkresa e MAS nr.1368 prot datë 19.02.2024

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

ZV/REKTORI AKADEMIK
PROF.AS.FROSINA LONDO QYRDETI

Konceptoi: A.Bozhani (Pergj.e Kurrikulave)

Konfirmoi: A.Breshanaj (Drejtoresh e Edukimit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË

Handwritten signatures and notes:
500
28.02
24
Seyoni kodi
Lico

Nr. 46/2 prot.


Vlorë, më 29.02.2024

Lënda: Përcjellje për miratim e Rregullores së Programit të Studimit Master i Shkencave në "Administrim Publik".

PROF.DR. ROLAND ZISI
REKTOR
UNIVERSITETI I VLORËS "ISMAIL QEMALI"

Në mbështetje të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instotucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", bazuar në Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, miratuar me Vendim Senati, Nr.20, datë 11.04.2022, dhe në përgjigje të miratimit të fazës së parë të aplikimit për riorganizim të programit të Masterit Profesional në Administrim Publik, në Master i Shkencave në "Adminuistrim Publik", ju përcjellim për miratim të mëtejshëm Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Adminuistrim Publik", të aplikuar për riorganizim, dhe miratimit nga Departamenti i Biznesit.

DEKANI
PROF. ALBERT QARRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I BIZNESIT

Nr. 4611 prot.

Vlorë, më 28.02.2024

Lënda: Përcjellje për miratim të mëtejshëm e Rregullores së Programit të Studimit Master i Shkencave në "Administrim Publik".

PROF.DR. ALBERT QARRI
DEKANI
FAKULTETI I EKONOMISË

Në mbështetje të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instotucionet e Arsimit të Lartë në Republikëen e Shqipërisë", bazuar në Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, miratuar me Vendim Senati, Nr.20, datë 11.04.2022, dhe në përgjigje të miratimit të fazës së parë të aplikimit për riorganizim të programit të Masterit Profesional në Administrim Publik, në Master i Shkencave në "Adminuistrim Publik", ju përcjellim për miratim të mëtejshëm Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Adminuistrim Publik", të aplikuar për riorganizim, dhe miratimit nga Departamenti i Biznesit.

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT

Prof. As. Dr. Fioralba VELA



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I BIZNESIT

RREGULLORE E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT

MASTER I SHKENCAVE NË "ADMINISTRIM PUBLIK"

DEPARTAMENTI I BIZNESIT

SHKURT 2024

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin e MASR, për çeljen e Programeve të Studimit, Statutit të Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe Rregullores të Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës.

Neni 2 Misioni dhe objektivat

- a) Rregullorja synon të krijojë një kuadër të plotë dhe të qartë për studimet e ciklit të dytë të programit Master i Shkencave në “Administrim Publik”, si dhe të përcaktojë rregulla standarte të përgatitjes, organizimit dhe administrimit të studentëve të këtij cikli.
- b) Kjo rregullore i bashkëngjitet Rregullores së Brendshme të Departamentit të Biznesit dhe shtrin efektin e saj mbi njësinë mësimore – shkencore përgjegjëse për organizimin e programit “Master i Shkencave” në “Administrim Publik”.
- c) Ky program studimi përfshihet në ciklin e dytë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe siguron Diplomë Universitare “Master i Shkencave” në “Administrim Publik”.

KREU II ORGANIZMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Neni 3 Programi i studimit

Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Publik” siguron Diplomë Universitare Master i Shkencave në “Administrim Publik”. Ky program organizohet dhe shprehet përmes grumbullimit të krediteve sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Për të fituar këtë diplomë nevojiten 120 kredite (ECTS). 60 kredite (ECTS) përfaqësojnë ngarkesën e punës së një viti akademik studimesh.

- a) Viti akademik është njësia kohore bazë e studimeve. Një vit akademik përbëhet nga 2 semestra dhe shtrihet në intervalin nga 30 deri 40 javë mësimore, sipas udhëzimeve të MASR (30 javë mësim dhe 6-8 javë provime dhe provim formimi / mbrojtje teze diplome). Fillimi dhe përfundimi i vitit akademik përcaktohet me Udhëzim të MASR në çdo fillim viti akademik.

- b) Çdo semestër zgjat 15 javë mësimore. Organizimi i vitit akademik, datat e fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve, shpallen nga rektori në fillim të vitit akademik.
- c) Në zbatim të Nenit 56 “Plani Mësimor” të Rregullores së Universitetit, në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në kurrikulat e programeve të studimit, departamentet hartojnë planin mësimor të vitit, i cili miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe nga Rektori. Për çdo kurs hartohen programet lëndore (syllabuset).
- d) Në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në kurrikulat e programeve të studimit, departamentet përcjellin për miratim planin mësimor tek Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Për çdo kurs hartohen programet lëndore (syllabuset).
- e) Moduli themelor i studimit është lënda semestrale me kredite (ECTS) të bashkëngjitura në planin mësimor të miratuar të programit të studimit.
- f) Numri i caktuar i krediteve fitohet pas përfundimit me sukses të disiplinës, siç është përshkruar në këtë Rregullore dhe në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.
- g) Vlerësimi i studentëve bëhet nga personeli akademik përkatës që zhvillon disiplinat mësimore, i cili organizon sipas gjykimit të tij kontrole me gojë, me shkrim, ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë, detyra të pavarura, detyra kursi etj., në përputhje me mënyrat e vlerësimit të përcaktuara në këtë Rregullore dhe në Rregulloren e Brendshme të Universitetit .
- h) Studenti përfundon studimet në këtë program studimi dhe merr diplomë kur ka likuiduar me sukses gjithë disiplinat mësimore të parashikuara në planin mësimor përkatës, ka mbrojtur me sukses tezën e diplomës, dhe ka fituar 120 kredite (ECTS). Kjo formë vlerësimi përmban tematika të lëndëve të drejtimit që ka ndjekur në program, me qëllim krijimin dhe vlerësimin e dijeve të fituara në disiplina të ndryshme.

Neni 4

Pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Dytë të studimeve Master i Shkencave në “Administrim Publik”

Pranimi i studentëve në Programin e Ciklit të Dytë të studimeve Master i Shkencave në “Administrim Publik”, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, realizohet bazuar në nenin 76 të Ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në udhëzimet e përvitshme të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vetë kriteret e parashikuara në nenin 65 të rregullores së UV si dhe në kriteret e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga SA i institucionit.

Neni 5

Ndërprerja e studimeve

Studenti mund t’i ndërpresë studimet pasi të ketë njoftuar paraprakisht për këtë ndërprerje dekanin e fakultetit. Ai mund të rifillojë studimet para ose pas konsumimit të lejes, në fillim të çdo semestri apo në të njëjtën datë pas së cilës ai është larguar. Në çdo rast ai duhet të ketë përmbushur të gjitha detyrimet që përmban rregullorja mësimore e programit të studimit.

Ndërpreja e studimeve është e përcaktuara në Nenin 104 “Ndërprerja dhe rifillimi i studimeve” të Rregullores së Brendshme të Universitetit.

Neni 6

Transferimi i studimeve, njohja e krediteve dhe ekuivalentimi i lëndëve

Është e mundur njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë universitetit. Pranë Departamentit ngrihet Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit i cili vlerëson dokumentacionin e studentit të përcjellë nga Sekretaria Mësimore dhe bën njohjen e krediteve përkatëse për disiplinat mësimore të likuiduara për të cilën kërkohet njohja e krediteve. Modalitetet dhe procedurat për transferimin e studentëve janë të përcaktuara në Nenin 83 “Transferimi i studimeve” të Rregullores së Brendshme të Universitetit.

KREU III

RREGULLAT E NDJEKJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE PROCEDURAT E DIPLOMIMIT

Neni 7

Frekuentimi dhe shlyerja e detyrimeve të lëndëve

- a. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%.
- b. Numri i mungesave të lejuara përlllogaritet për gjithë semestrin përkundrejt numrit total të orëve për gjithë kursin.
- c. Çdo pedagog pajiset me regjistrin përkatës i cili përmban informacion mbi veprimtarinë e mësimdhënies dhe frekuentimit. Ai firmoset nga pedagogu i lëndës pas zhvillimit të leksioneve, apo seminareve si dhe nga drejtuesi i departamentit në fund të semestrit. Pedagogu përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin.
- d. Studentët e ciklit të dytë të studimeve regjistrohen në lëndët që ofrohen në atë sezon sipas planit mësimor të sugjeruar, në të cilat nuk është regjistruar asnjëherë më parë.
- e. Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin (jo më pak se 75 % frekuentim), atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (M) dhe përsërit kursin në semestrat e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (M) do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale.
- f. Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet “NP” (Nuk u paraqit). Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi “NP” (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët nuk kanë detyrimin dhe nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim final, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

- g. Sekretaria mësimore e Departamentit të Biznesit përgjigjet për administrimin e informacionit mbi detyrimet akademike të studentëve në këtë program studimi.

Neni 8

Rregullat e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimi i lëndës

Bazuar në nenet 89-97 të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë:

- a) Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor.
- b) Kontrolli i dijeve në këtë program studimi të ciklit të dytë realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi final gjithëpërfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës.
- c) Orari i provimeve finale duhet të shpallet para përfundimit të semestrit. Për semestrin e verës dhe sezonin e riprovimeve të dimrit, kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final.
- d) Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në notë etj., përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs.
- e) Pesa (përqindja) e formave të tjera të vlerësimit, të parashikuara në syllabus-in e lëndës, detyra kursi, projekte individuale, etj., janë jo më shumë se 10-15% e vlerësimit të përgjithshëm, të gjitha së bashku.
- f) Në rastin kur studenti nuk merr pjesë në një provim, por paraqet dokumentacion ku justifikon arsye të forta si probleme shëndetësore serioze (psh. shtrim në spital, aksident të rëndë), raste të jashtëzakonshme fatkeqësish familjare, apo raste urgjencash publike, vendimin për një mundësi tjetër për dhënien e provimit e merr Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, duke u bazuar në kërkesën me shkrim të paraqitur nga studenti. Dekani ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë për të verifikuar mungesën.
- g) Kurset janë të gjitha semestrale. Nëse studenti nuk kualifikohet, pra ka shënim mungesë (m) në proceverbalin përfundimtar të kursit, ai ka të drejtën dhe detyrimin ta frekuentojë përsëri atë kurs, në semestrat pasardhës kur kursi ofrohet. Nëse kursi për arsye të ndryshme nuk do të ofrohet më (p.sh për arsye të ndryshimeve në kurrikula), studenti ka të drejtë të frekuentojë atë kurs që mund të ekuivalentohet me kursin që nuk ofrohet më, ose në rast të kundërt hapet kursi që nuk ofrohet më pavarësisht numrit të studentëve, vetëm për studentët që janë brenda afatit maksimal të studimeve të tyre. Krahas kurseve të përcaktuara në planet semestrale, studenti ka të drejtë të frekuentojë njëkohësisht edhe kurse të tjera për të cilat ka shënimin mungesë (m) nga semestri paraardhës, por duke respektuar rregullat e numrit të krediteve të regjistruara në një semestër dhe rregullat e përgjithshme të regjistrimit, sipas nenit 98 të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- h) Tezat e provimit në të gjitha kontrollet hartohen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.
- i) Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të provimit me gojë dhe për provimin me shkrim, brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të tij. Studentët

informohen mbi rezultatet e provimit në lirezën e tyre elektronike, por nëse nuk e kanë marrë këtë informacion për arsye të ndryshme, informohen drejtëpërdrejtë nga pedagogu duke respektuar privatësinë e informacionit.

- j) Në raste paqartësish, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të lektorit të kursit, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim Drejtuesit të Departamentit që mbulon kursin përkatës.
 - k) Kur studenti në provim vlerësohet me notën 4 (katër) ose "NP" (Nuk u paraqit), ai ka të drejtën të regjistrohet për të shlyer këtë lëndë vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve në dimër.
 - l) Regjistrimi në këtë rast do të bëhet sipas rregullit të përgjithshëm të regjistrimit të përcaktuar në nenin 85 të rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
 - m) Mesatarja e studentit llogaritet si mesatare e ponderuar. Shuma e prodhimit të notave përfundimtare me kreditet përkatëse të lëndës pjesëtohet me totalin e kredive. (Bazuar në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë neni 68, miratuar nga Senati Akademik me Vendim nr.57, datë 06.09.2018, i ndryshuar me vendim Nr 75, datë 19.11.2018, vendim Nr 5 datë 04.02.2019, vendim Nr 11, datë 27.02.2019,).
- Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, akordon për studentët në përfundim të studimeve titujt e nderit në tre nivele, në bazë të mesatares së përgjithshme të notave si më poshtë:
1. 8.00-8.89, cum laude
 2. 8.90-9.39, magna cum laude
 3. 9.40-10.00, summa cum laude

Këta tituj lëshohen së bashku me diplomën universitare të fituar nga studenti.

Neni 9

Sistemi i vlerësimit

Bazuar në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë neni 68, miratuar nga Senati Akademik me Vendim nr.57, datë 06.09.2018, i ndryshuar me vendim Nr 75, datë 19.11.2018, vendim Nr 5 datë 04.02.2019, vendim Nr 11, datë 27.02.2019, Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, neni 96 "Sistemi i vlerësimit", pika 1, shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10. Nota më e ulët kaluese është nota 5 (pesë). Në procesverbalet e vlerësimit përfundimtar për studentin jo kalues (ngelës) vendoset nota 4 (katër). Në të gjitha format e kontrollit të dijës përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, sipas nenit 96, pika 2 e Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë.

Neni 10

Administrimi i dokumentacionit të provimeve

Bazuar në Nenin 92, pika 5 e Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë:

- a) Tezat e provimit me shkrim ruhen nga pedagogu i lëndes deri në përfundim të afatit të ankimimit të provimit, por jo më shumë se 15 dite kalendarike.

Neni 11

Ankimimi për rezultatin përfundimtar

- a) Bazuar në nenin 95, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Drejtuesit të Departamentit. Ai, ose dy pedagogë të caktuar prej tij, përcakton/një me vendin brenda 2 (dy) ditëve nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo. Ky vendim është i formës së prerë.
- b) Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me dispozitat e Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, atëherë me propozimin e përgjegjësit të departamentit, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit me gojë ose me shkrim dhe për ridhënien e provimit brenda ditës ose të nesërmen, pas përfundimit të tij.
- c) Ndryshimet në rezultatet e studentëve pasqyrohen në procesverbalin e ri të firmosur nga komisioni i cili i bashkëlidhet procesverbalit të mëparshëm dhe në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Univlora (UVMS-Univlora).

Neni 12

Përmirësimi i notës

1. Studentët e ciklit të dytë kanë të drejtë të përmirësojnë notën në çdo lëndë, por jo më shumë se katër përmirësime gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe jo më shumë se dy përmirësime në një vit akademik.
2. Përmirësimet e notës bëhen vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve të dimrit si dhe në datat e përcaktura nga Dekani i Fakultetit para mbrojtjes së diplomës, kundrejt një tarife të miratuar. Është detyra e tij të regjistrohet në kurset që do të përmirësojë notën, pasi më parë ka bërë kërkesën në sekretarinë e departamentit, e cila e përcjell informacionin tek Drejtoria e IT-së për të mundur aksesin e studentit në regjistrimin e kursit. Kërkesa bëhet të pakten 10 ditë para fillimit të semestrit të verës, sezonit të riprovimeve të dimrit dhe mbrojtjes së diplomës.
3. Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës së një lënde jo më shumë se një herë.
4. Studentët duhet të jenë në dijeni se mbetet në fuqi nota e përsëritjes së fundit, e cila do të pasqyrohet në transkriptin e notave që tregojnë ecurinë akademike të studentit, pavarësisht nëse kjo është nota më e lartë apo jo.
5. Nëse nota e përsëritjes së fundit është 4 (katër), rregullat akademike për shlyerjen e detyrimeve nuk ndryshojnë.
6. Në listën e notave që shoqërojnë diplomën do të pasqyrohen vetëm notat përfundimare kaluese (5,6,7,8,9,10).

Neni 13

Praktika profesionale

Bazuar në nenin 105, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë:

- a) Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, kur ajo përfshihet në programin e studimit. Me fillimin e vitit akademik, departamenti u komunikon studentëve kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe shlyerjes së saj.
- b) Praktikrat profesionale zhvillohen në institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.
- c) Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, personeli akademik që drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studentit përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet nga pedagogu që e drejton praktikën pasi merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo. Vlerësimi bëhet me notë.
- d) Studentët të cilët i transferojnë studimet nga IAL-të tjera në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës, por kanë lëndën e praktikës mësimore të vlerësuar Fitues/Jofitues dhe jo me notë, janë të detyruar që të zhvillojnë provimin e lëndës "Praktikë mësimore" por jo ta frekuentojnë atë.

Neni 14

Përgatitja e temës së diplomës

1. Në mënyrë që të përfitohet diploma Master i Shkencave, studentit duhet të shkruajë dhe të paraqesë, përpara një komisioni të vlefshëm, një tezë kërkimore shkencore, në një nga fushat bazë të trajtuara në program.
 - a. Zgjedhja e temës së tezës duhet të propozohet nga studentit dhe të jetë aprovuar nga udhëheqësi i tij/saj shkencor.
 - b. Realizimi me sukses i tezës kërkon angazhim maksimal të studentit, i cili duhet të zhvillojë kontakte të vazhdueshme dhe të raportojë në mënyrë sistematike tek udhëheqësi punën e kryer sipas një skeduli të përcaktuar paraprakisht.
 - c. Teza e diplomës duhet të përfaqësojë një punë kërkimore shkencore origjinale dhe të mos jetë paraqitur në ndonjë institucion tjetër arsimor.
 - d. Studentit duhet të përcaktojë qartë metodologjinë kërkimore (induktive apo deduktive) të studimit në varësi të kontekstit të studimit.
 - e. Struktura e temës duhet të jetë e qartë dhe duhet të zbatohet pavarësisht tipit të metodologjisë së përzgjedhur në të. Përmbajtja e tezës së diplomës duhet të paraqesë një shqyrtim të literaturës së huaj dhe të asaj vendase të viteve të fundit, e cila tregon se studentit e njeh mirë fushën e tij kërkimore dhe është në gjendje të paraqesë koncepte teorike, të analizojë dhe të krahasojë zhvillimin e modeleve teorike nga autorë të huaj apo vendas.
2. Punimi i diplomës për ciklin e dytë të studimit master duhet të ketë një numër faqesh minimalisht prej 50 faqe. Kriteret e punimit të temës së diplomës dhe formati i saj duhet të jetë konform atij të miratuar në Departament.

3. Studentit që i lind e drejta për t'u diplomuar me temë diplome, në fillim të semestrit përkatës, por jo më vonë se java e dytë, aplikon në sekretari për temë diplome duke plotësuar një formular ku propozon udhëheqësin e temës së diplomës. Ky i fundit miratohet nga drejtuesi i departamentit jo më vonë se java e katërt. Udhëheqësi i diplomës dorëzon një deklaratë ku të dy palët (udhëheqësi dhe studenti) kanë rënë dakort për të punuar së bashku mbi fushën e studimit të përzgjedhur, jo më vonë se java e tretë e semestrit. Afati i dorëzimit të punimit të temës së diplomës është një javë para datës së provimit të diplomës.

5. Detyrime të pedagogut udhëheqës

- a. Të dorëzojë në kohë propozimet për studentët që merr përsipër të udhëheq, si dhe fushën e studimit.
- b. Udhëheqje dhe takime këshilluese në periudha të rregullta kohore me studentët.
- c. T'u ofrojë studentëve udhëzime për shkrimin dhe mbrojtjen e temës si dhe për vlerësimin e saj.

6. Vlerësimi

Tema e diplomës vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash përpara një komisioni të ngritur në Departament.

Neni 15 **Diplomimi**

Bazuar në nenin 100, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë:

- a) Në përfundim të kursit të plotë të studimeve Master i Shkencave në "Administrim Publik", studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat e diplomimit janë paraqitur në kurrikulën e programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Publik".
- b) Sekretaria mësimore e Departamentit të Biznesit është e detyruar t'i përcjellë me shkresë të veçantë Drejtuesit të Departamentit dhe Dekanit të Fakultetit, listën e studentëve që kanë plotësuar detyrimet e një program studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar të cilët kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës. Sekretaria mësimore mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave.
- c) Drejtuesi i Departamentit pas marrjes së listës së studentëve ngre një komision ad hoc, i cili verifikon nëse këta studentë kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit. Pas verifikimit lista e studentëve që kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës, e firmosur nga anëtarët e komisionit, i përcillet drejtuesit të departamentit.
- d) Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të dytë, për fitimin e diplomës parashikohet përgatitja e një teze diplome ose punimi të pavarur.
- e) Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga drejtuesi i departamentit (referuar nenit 6 shkronja "g" të rregullores së programit).
- f) Mbrojtja e diplomës bëhet e hapur. Procedura e mbrojtjes konsiston në përgatitjen e një teze diplome ose punimi të pavarur. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëheqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë. Juria dhe kryetari i saj miratohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Drejtuesit të Departamentit dhe përbëhet nga 5(pesë) anëtarë. Shlyerja e detyrimeve të programit të studimit dhe çdo detyrimi tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit, është kusht paraprak për kryerjen e mbrojtjes së tezës së diplomës.

- g) Drejtuesi i Departamentit i përcjell Dekanit të Fakultetit listën e studentëve të diplomuar. Dekani nëpërmjet një shkrese ia përcjell këte listë Zyrës së Regjistrimit për të përgatitur diplomat përkatëse.
- h) Në raste të veçanta kur studentët pengohen për t'u diplomuar vetëm për një lëndë të cilën e kanë frekuentuar dhe kanë vleresimin me notën 4 (kater) ose shënimin "NP", Dekani i Fakultetit përkatës cakton data të posaçme për këto provime, përpara datës së përcaktuar për mbrojtjen e tezës së diplomës.
- i) Diplomimi në këtë program studimi të ciklit të dytë bëhet gjatë gjithë vitit akademik, datat dhe afatet përcaktohen nga Dekani i Fakultetit, duke mos krijuar pengesa në kohë për studentët që diplomohen.
- j) Kandidati që rrëzohet në mbrojtjen e diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në një datë të caktuar nga Dekani i Fakultetit në semestrin pasardhës.

Neni 16

Modalitetet e provimit

- a. Në përfundim të kursit të plotë të studimeve universitare, studenti ka të drejtë të diplomohet. Studenti i regjistruar në programin Master i Shkencave ka të drejtë të paraqitet në mbrojtjen e tezës së diplomës vetëm pasi ka kaluar me sukses testin internacional të gjuhës së huaj.
- b. Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 76 dhe në aktet nënligjore, për programin e integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave, kriter diplomimi është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj është i përcaktuar me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.
- c. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit të studimit.
- d. Studenti, para mbrojtjes së punimit të diplomës duhet të ketë likuiduar të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me universitetin, bibliotekën shkencore, konviktet, etj.

Neni 17

Pajisja me diplomë

Bazuar në nenin 100, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë:

- a) Studentët që kanë plotësuar detyrimet e një programi studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit, pajisen me diplomë e cila është një dokument zyrtar.
- b) Diplomat e Programit të Ciklit të Dytë të studimeve Master i Shkencave në "Administrim Publik" shoqërohet me Listën e Notave (në listën e notave që shoqërojnë diplomën pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese ≥ 5 të çdo lënde) dhe me suplementin e diplomës. Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të

- arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës.
- c) Përmbajtja dhe forma e diplomës është e përcaktuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Diploma nënshkruhet prej Dekanit të Fakultetit Ekonomisë dhe Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
 - d) Për këtë program të ciklit të dytë të studimeve lëshohet diploma: Diplomë Master i Shkencave në "Administrim Publik".

Neni 18 **Tërheqja e diplomës**

Bazuar në nenin 101, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë:

- a) Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës.
- b) Nëse prania e të diplomuarit është objektivisht e pamundur, tërheqjen e diplomës mund t'a bëjë një nga pjesëtarët e familjes, i pajisur me prokurë të posaçme e cila bashkëngjitet në regjistrin e tërheqjes së diplomave, duke paraqitur dhe një dokument identifikimi të tij.
- c) Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheq atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt. Nëse i interesuari e tërheq diplomën e parregullt, në rast se i humbet origjinali ose i dëmtohet duke iu bërë i papërdorshëm, universiteti nuk lëshon dublikatë. Lejohet vetëm dhënia e listës së notave të fituara dhe vërtetim me fotografi i cili është ekuivalent me diplomën, pasi nënshkruhet nga rektori i universitetit, dekani dhe përgjegjësi i zyrës së regjistrimit. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Diploma e plotësuar në mënyrë të parregullt, asgjësohet me një komision të përbërë prej tre anëtarësh të caktuar me urdhër të dekanit me hartimin e procesverbalit përkatës, i cili depozitohet në zyrën e regjistrimit, përpara se i interesuari të pajiset me vërtetim me fotografi ekuivalent me diplomën.
- d) Nëse një shtetas i diplomuar në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë rezulton me dy dokumente diplomimi, diplomë origjinale dhe vërtetim me fotografi ekuivalent me diplomën, do të quhet i vlefshëm dokumenti i lëshuar në datën më të vonë.
- e) Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni të përgjithshme për të gjithë fakultetet në shkallë universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit Akademik, të profesoratis, administratës dhe studentëve.
- f)

KREU IV **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTËVE**

Neni 19 **Të drejtat e studentëve**

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve janë të parashikuara në nenin 73 të Statutit të UV, ndërsa shkeljet disiplinore nga studentët parashikohen në nenin 103 të Rregullores së UV- së.

Studenti ka të drejtë:

- a. Të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tij.
- b. Të përdorë pajisjet, bazën materiale dhe laboratorike të universitetit sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, bibliotekën dhe mjediset sportive e kulturore të universitetit.
- c. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese, si në Senatin Akademik, në Këshillin e Administrimit, ku janë të regjistruar, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit.
- d. Të organizohet në shoqata të ndryshme jopolitike në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse.
- e. Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit kur plotëson kushtet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, Senatit e në marrëveshjet ndërshtetërore ose ndëruniversitare.
- f. Të përfitojë shpërblime të veçanta që akordohen nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë sipas ligjit dhe kriterëve të caktuara nga Senati Akademik.
- g. Të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit
- h. Të ankohet për shkelje të rregullave dhe standarteve akademike nga ana e pedagogëve, mosrealizimin e procesit të mësimdhënies, rregullat për zhvillimin e provimit dhe për vlerësimin e tij të pamerituar.
- i. Të ankohet për shkelje të etikës akademike, të konfliktit të interesit dhe të çdo rasti tjetër që çënon integritetin e studentit.
- j. Të ndjekë studimet në një degë të dytë, në sistem të ndryshëm nga ai që ndjek, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, në vendimet e Senatit apo në aktet e posaçme të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit.

Të drejta të tjera të studentëve janë përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e Universiteti "Ismail Qemali" Vlore dhe në Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlore.

Neni 20

Detyrimet e studentëve

Studenti është i detyruar:

- a. Të njohë me hollësi Statutin, Rregulloren e Universitetit të Vlores dhe çdo rregullore tjetër, e detyrimet që lindin për të, dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërt, universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.

- b. Të njohë të gjitha kërkesat e përgjithshme të universitetit, si dhe kërkesat specifike të programit në fushën që ka zgjedhur. Studenti është përgjegjës për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave dhe rregulloreve përkatëse në bazë të diplomave që synon.
- c. Të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, nga kjo rregullore dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor për arsimin e lartë.
- d. Të respektojë Kodin e Etikës së univeristetit.
- e. Të shlyejë detyrimet e përcaktuara në programin e studimit si dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material ndaj universitetit.
- f. Të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të parashikuara në ligj.
- g. Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të universitetit nga ana e tij; dëmet materiale që ai mund të ketë bërë zhdëmtohen në masën e përlogaritur.

Detyra apo përgjegjësi të tjera të studentëve janë përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlore dhe në Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlore.

Neni 21

Përgjegjësi të tjera të studentëve

Përgjegjësitë e studentit përfshijnë ndër të tjera edhe pikat më poshtë:

- a. Studenti duhet të njohë dhe të respektojë rregullat e zhvillimit të orës së mësimi të përcaktuara në syllabus dhe të komunikuar në auditor nga pedagogu.
- b. Studenti duhet t'i drejtojë ankesat akademike në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor tek autoritetet drejtuese.
- c. Studenti duhet të respektojë oraret e konsultimeve të komunikuar nga pedagogu.

Neni 22

Masat disiplinore për studentët

Shkelje të rregullave të universitetit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çënojnë personalitetin e personelit akademik, të çdo punonjësi tjetër të universitetit dhe cdo studentit, normat etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, fyerjet, sharjet, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj., kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale. Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:

- a) Vërejtje me shkrim;
- b) Paralajmërim për pezullim ose përjashtim nga universiteti;
- c) Pezullimin nga universiteti për një semestër ose një vit;
- d) Përjashtim nga universiteti "Ismail Qemali" Vlorë;
- e) Përjashtim përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.

Vendimin për "Vërejtje me shkrim", "Paralajmërim për pezullim ose përjashtim nga universiteti" dhe "Pezullim nga universiteti për një semestër ose një vit" e merr dekanati përkatës. Në raste të veçanta të parashikuara në Kodin e Etikës këto vendime mund të merren nga Rektorati.

Vendimin për "Përjashtimin nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë" (heqje vetëm të së drejtës së studimit të filluar) dhe "Përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (duke mos i lejuar të fitojë të drejtë studimi të mëpasshme) e merr Rektorati i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, mbi bazën e propozimit të dekanatit.

Studenti konsiderohet i rehabilituar, nëse nuk bën shkelje tjetër me kalimin e tre muajve për vërejtjen, brenda gjashtë muajve për paralajmërimin dhe një viti për pezullimin.

KREU V KOMUNIKIMI

Neni 23

Rregullat e sjelljes akademike

1. Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integriteti akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:
 - a. **Mashtrim në provime.** Këtu përfshihet: përdorimi i materialeve si libra dhe/ose shënime në formë të printuar apo elektronike kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, kopjimi nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, lejimi i dikujt tjetër për të kopjuar punën tënde, zëvendësimi i punës tënde me punën e dikujt tjetër, ose të tjera forma shkeljesh në sjellje gjatë provimeve.
 - b. **Plagjiaturë** e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër duke i konsideruar ato të veta.
 - c. **Falsifikimi** i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.
2. Pedagogët duhet të respektojnë standartet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:
 - a. Të informojnë dhe të udhëzojnë studentët mbi procedurat dhe standartet e punës kërkimore, si dhe mbi dokumentacionin e kërkuar për të kryer detyra në një kurs të caktuar apo në kontekstin e një disipline të caktuar.
 - b. Të ndërmarrin hapa konkretë për të dalluar dhe parandaluar mashtrimin.
 - c. Të raportojnë sjelljen akademike të dyshuar jo etike tek dekani.
 - d. Të paraqesin evidencë të plagjiaturës, të mashtrimit në provime apo raporte laboratorit, të falsifikimeve të dokumentave apo të tjera forma sjelljeje të pandershme akademike në autoritetet drejtuese përkatëse.
3. Studentët duhet të respektojnë standardet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:
 - a. Të jenë në dijeni të praktikave dhe standardeve të shkollimit të ndershëm.
 - b. Të ndjekin udhëzimet e pedagogëve në lidhje me provimet dhe detyrat në mënyrë që të evitojnë një paraqitje të keqe të punës.

- c. Të jenë të sigurt që rregulla të veçanta në lidhje me dokumentimin e detyrave të kursit, të procedurave të provimit, të përdorimit të informacioneve e programeve kompjuterike, etj., janë kuptuar qartë.
- d. Të evitohen aparencën e mashtrimit (të lënit përshtypje sikur po mashtrojnë). Nëse studentët janë të bindur që praktikat e përdorura nga pedagogu janë të favorshme ndaj mashtrimit, ata mund t'ia përcjellin këtë mesazh Drejtuesit të Departamentit, Dekanit ose t'i drejtohen me ankesë të drejtëpërdrejtë Rektorit. Raste të tilla do të gjykohen dhe vlerësohen sipas rregulloreve në fuqi.

Neni 24

Normat etike gjatë komunikimit Personel Akdemik – Student

1. Gjatë veprimtarisë së mësimdhënies shpesh vihen re problematika rreth koordinimit të punës së stafit me studentët. Për këtë qëllim kjo Rregullore sugjeron të ndiqen disa udhëzime praktike të miratuara si më poshtë:
 - a) Studenti është i detyruar të zbatojë e respektojë Kodin e Etikës të miratuar në UV.
 - b) Kontakti i pedagogut me studentin për aspekte të mësimdhënies apo kërkimit shkencor do të bëhet vetëm në ambientet e auditoreve, laboratoreve dhe në asnjë rast jashtë tij.
 - c) Komunikimi me studentin mund të bëhet në rrugë elektronike në adresën e pedagogut e cila është regjistruar më parë në departament.
 - d) Justifikimet nga ana e studentëve tek pedagogu për mungesat gjatë vitit pranohen vetëm pas dorëzimit të raporteve të marrë nga komisione të posacëm.
 - e) Në rast të vonesave të pedagogut në auditor studentit duhet të presë disa minuta, dhe nëse pedagogu nuk ka njoftuar paraprakisht ai mund të largohet.
 - f) Në auditor, laboratorë si dhe gjatë provimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve të komunikimit.
 - g) Në ditën e provimit studentit respekton me përpikmëri datën, vendin e provimit, si dhe siguron mjetet e nevojshme (stilolaps, makinë llogaritëse, mjet identifikimi).
 - h) Në ambjentet e provimit nuk lejohet prania e familjarëve të studentit përveçse personave të autorizuar nga ana e Drejtuesit të Departamentit (pedagogë, sekretare).
 - i) Pedagogu ju'a komunikon notën studentëve duke respektuar konfidencialitetin (në mungesë të sistemit) ose bën verifikime të vlerësimit në një orar e sallë të caktuar.
2. Për komunikime të pedagogut me studentët që kanë tema diplome hartohet një grafik i konsultimit në një sallë e ditë të caktuar javore.

Neni 25

Çështje akademike

Çdo njësi akademike duhet të respektojë procedurat për zgjidhjen e ankesave, në lidhje me vlerësimin, standartin dhe cilësinë e mësimdhënies, situatat brenda në klasë dhe cdo problem tjetër akademik. Për rastet e ankesave në lidhje me vlerësimin, ndiqet ajo procedurë e përcaktuar në nenin 95 të rregullores së UV.

Neni 26
Çështje jo akademike

Personeli i universitetit dhe studentët mund të hasin situata problematike gjatë kohës së punës apo të studimeve në universitetin "Ismail Qemali" Vlorë në të cilat mund të përfshihen rastet e fyerjeve, sharjeve, konfrontimeve fizike. Qëndrimi diskriminues apo ngacmimi seksual, sharjet apo fyerjet raciale, sharjet për orientimin seksual, për ngjyrën, fenë, bindjet, origjinën kombëtare apo prejardhjen, gjendjen martesore, gjendjen familjare etj., kërkojnë vëmendje të veçantë në zgjidhjen e tyre.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 27

Çdo çështje që lind nga zbatimi i kësaj rregulloreje dhe nuk mbulohet prej saj, rregullohet me Rregulloren e Brendshme të Universitetit. Në rast se edhe kjo e fundit nuk e mbulon, atëherë Departamenti i propozon Rektorit dhe Senatit Akademik propozimin përkatës për miratim. Asambleja e Departamentit të Biznesit ka të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, dhe përcjelljen për miratim në Senatin Akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1768 Prot.

Tiranë, më 19 02 2024

Lënda: Njoftim mbi vlerësimin e aplikimit.

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Adresa: Skelë, Rruga "Kosova", 9401, Vlorë

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përfunduar shqyrtimin e aplikimit për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë, nga Master Profesional në "Administrim Publik", në Master i Shkencave në "Administrim Publik".

Ju bëjmë me dije se **aplikimi juaj kalon në fazën tjetër.**

Për sa më sipër, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit, duhet të ngarkoni elektronikisht dokumentacionin e përcaktuar në Kreun IV/A, të udhëzimit nr.1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të ndryshuar.

Sjellim në vëmendjen tuaj se në fazën e dytë të aplikimit duhet të paraqisni kodin për programin e studimit, referuar vendimit nr. 310, datë 11.05.2022 të Këshillit të Ministrave "Për specifikimet dhe përmbajtjen e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZËVENDËSMINISTËR

ALBANA TOLE